

MUMIN Z. SHUTAJ

**PËRÇAPJE NËPËR VEPRËN E SEVASTI QIRIAZIT “JETA IME”
VËSHTRUAR NGA KËNDI I TRASHËGIMISË ETNOKULTURORE**

930.85(=18)

Abstrakt: Në këtë trajtesë jemi munduar të përvijojmë disa elemente etnokulture shqiptare që kanë të bëjnë me qytetin e Manastirit dhe rrethinat e tij si një nga qendrat e njohura të kulturës dhe etnokulturës shqiptare gjatë periudhës, gjysma e dytë e shekullit XIX-të dhe XX-të nga këndi i portretizimit, se me ç’sy i sheh vlerat e tilla etnokulturore të atij ambienti z. Sevasti Qiriazit në librin e saj të kujtimeve, Jeta ime. Me kujdes të veçantë kemi shëtitur nëpër tërë këto tematika, të cilat ajo i pasqyron në këtë vëllim, ndaj jemi mbështetur në ato pika nga lëmia përkatëse, pra disa segmente nga etnokultura shqiptare e këtij ambienti. Nga këndi ynë i vështrimit i kemi përzgjedhur për trajtim duke u bazuar në të dhënat përshkruese si ambient kujtim memorie më shumë, e që në ato pleksen të dhëna tejet të rëndësishme nga fushë e traditës së trashëguar kombëtare të kësaj ane e më gjerë. Ajo ka prekur më shumë segmente nga kjo fushë, ndaj edhe iu kemi qasur të i themi disa fjalë lidhje me këtë, vështruar nga këndi ynë e vlerësimit të këtij thesari vlerash nga trashëgimia jonë të cilat na janë ofruar përmes librit të zonjës Sevastia.

Sevastia Qiriazit njëra nga figurat e kolosëve shqiptarë të Rilindjes Kombëtare

Paraprakisht e ndiej detyrim profesional dhe intelektual t’i shprehë mirënjohje dy autorëve amerikan të nderuar të cilët e përgatitën për botim pas disa dhjetëvjetëshashdorëshkrimin e mësueses së popullit S. Qiriazit, Dana Stucky, dhe David Hosaflook, dhe njëkohësisht, personelit drejtues; Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve – Shkup, të cilët e mundësuan daljen në dritë të veprës së zonjës së nderuar Sevasti Qiriazit – Dako; kujtime jete titulluar, “Jeta Ime.” Në këtë vepër hasim në vlera të shumta historike të kohës, të më shumë fushave si: etnokulturë, arsim, filozofi, organizime politike, humanitet, dhe mbi të gjitha sakrificat subline dhe ideale tëbrumosura në një, të cilat burimin e kanë te vetë njeriu ynë, pra te vetë Sevastia, dhe familja e saj, si shembull i veçantë patriotizmi dhe dashurie për kombin e atdheun. Portretin dhe veprën e kësaj intelektuale dhe gruaje padilema mund ta konsiderojmë monument ndër trashëgiminë tonë shumëanshmërisht. Mirëpo në kësaj radhe do t’i qasemi një segmenti tejet të rëndësishëm, pra, nga lëmi e trashëgimisë kulturore ku në rrëfimet e saj ajo përveç tjerash na ka lënë nëpër faqet e kësaj vepre të çmuar. Zonja Sevastia, ka jetuar dhe vepruar në një periudhë lëvizjesh të mëdha politike suazash globale, tejet të turbullta, me theks të veçantë ndër hapsirën shqiptare, dhe ajo përballet me këto situata tejskajshëm tragjike të cilat po e godisnin kombin shqiptar në ato kohëra. Andaj ajo me përkushtim të pashoq e sakrificat merr mbi supë përgjegjësi dhe i del përballë së keqes dhe qëjep nga vetja gjithçka në suaza të fuqisë personale për atdheun e popullin por edhe në fund na len këtë vepër ku flet e përshkruan ngjarjet më të rëndësishme, dhe na i ofron në formë kujtimesh jete që ta njohim atë realitet në mënyrën më të mirë edhe në ditët tona, pas mbi një shekulli po e shijojmë realitetin e kohës së saj. Andaj besoj të kemi të drejtë që kësaj vepre t’i japim atributin e monumentit për disa arsye që duken gjatë leximit, e që nuk është vepër shkencore por vepër përjetimesh. Shikuar nga këndi etnokulturor

rrëfimin e zonjës Sevastia në këtë volum shkrimi gjejmë të pasyruara një sërë vlerash nga tradita popullore shqiptare e kohës, përmes së cilës përçon deri tek ne të dhëna tejet autentike edhe nga kjo fushë. Me theks të veçantë këtu hasim ta njohim mënyrën e jetesës në qytetin e Manastirit e Korçës, dhe asaj gjeografie rajonale shqiptare siç janë: veshjet, mënyrën e jetesës, mënyra e të ushqyerit, arqitektura dhe dekori shtëpiak, trajtimi i gruas në kohë dhe hapsirë, vrojtuar edhe nga këndi i lindjes së foshnjave, raportet ndërnjerëzore dhe familjare, harmoninë si përfaqje në lidhje gjaku e më gjërë, ndjenjat e atdhedashurisë dhe atë identitare deri në sakrificë etj. Që në nismë të librit të saj, pra rrëfimit, në formë të shkruar, ajo na pasqyron një nga elementet etnokulturore të kohës përpara mbi një shekulli, dhe atë duke e përshkruar natyrën e Shqipërisë etnike, kubën fjalë edhe për ca nga disa element të ambientit shtëpiak ku ndër të tjera thekson. *Mua dhe vëllezërve e motrave na janë treguar mjaft rrëfenja drithëruese. Në dhomën e shtëpisë sonë në Manastir kishim një vatër mjaft të madhe dhe ky ishte vendi ynë i pëlqyer ku mblihdeshim gjatë mbrëmjeve të gjata të dimrit. Uleshim të gjithë në dysheme rreth e rrotull vatrës ku digjej zjarri, bubulak dhe piqnim gështenja. Dhoma ishte e madhe katrore, me mure të veshura me dërrasa të thjeshta të lyera me bojë. Në të dyja anët e vatrës kishte rrogoza kashte të mbuluara me rrugica të buta të kuqe me bordura të zeza, ngjyrat tona kombëtare, dhe një qilim i madh që mbulonte gjithë pjesën tjetër të dyshemesë. S. Q. Jeta ime, fq. 15.* Vetë fillesa e qasjes së rrëfimit lidhje me jetën e saj, pra të Sevastisë lidhet menjëherë drejtpërdrejtë me një sërë elementesh të kushteve dhe ambientit në të cilin bënte jetë familja Qiriazit, dhe vetë zonja. Jo rastësisht ajo e pasqyron këtë kaptinë meqë zonja në fjalë, me këto e lidh, dhe i jep frymë rrëfimit portretizues si fillesë e zhvillimit të ngjarjeve në të ardhmen duke prekur lidhjen shpirtërore e fizike me kushtet dhe ambientin familjar dhe atë të arealit më të gjerë kombëtar si pasqyrim historik shteghapës në të ardhmen që do të pasojë njëkohësisht, apo ndërkohë. Të dhënat që na ofron për jetesën e familjen e saj Sevastia përmes kujtimeve, na e mundëson ta njohim më për afër nivelin e gjendjes ekonomike të tyre për kohën, çka mund të nënkuptojmë njërin nga segmentet e mënyrës së jetesës dhe nivelin kulturor e edukativ. Njëkohësisht rregullat e të ushqyerit ku në vazhdim thekson: *Vakti kryesor (i të ushqyerit të ditës) ishte ai i darkës, pas perëndimit të diellit, kur në mes të dhomës shtrohej sofa, një tavolinë e ulët dhe e rrumbullakët që ngrihej diçka më shumë se një pëllëmbë nga dyshemeja. S. Q. Po aty fq. 17.* Ajo përmes këtyre detajeve përshkruese na ofron njohuri lidhje me këtë element nga tradita jonë e të ushqyerit, ngase vetëm në mbrëmje familja mund të bashkoheshin e të uleshin rreth tryezës për të ngrënë që të gjithë, andaj darkës i jepej rëndësia kryesore e të ngrënies ushqimin më me vlera gjatë ditës, kurse dy racionet tjera ditore konsideroheshin më sekondare. Kjo metodologji e të ushqyerit ndër popullin tonë ka qenë e shprehur pjesërisht deri vonë rreth viteve, 1970 – 80, meqë kushtet e dirigjonin një gjë të tillë, me theks të veçantë këtë element popullsisë ua impononin rrethanat dhe mënyra e jetesës në fshat, por edhe atij qytetarit tonë i cili merrej me zeytari apo ndonjë profesion tjetër siç ishin paraardhësit e Sevastisë. E njeriu ynë në ato kohë tejet pak individ kishte të cilët bënin detyra shtetërore administrative, ngase këta ndodheshin nën robëri të osmanlinjve, andaj edhe tretmani i tyre nga ana e sunduesit ka qenë ai i robit. Ajo ndër të tjera si më poshtë thekson: *Oborri ishte shumë i madh dhe i rrethuar nga një mur i lartë me gurë të mëdhenj. Shtëpia dykatëshe ishte gjithashtu një ndërtim prej guri. Pemishtja ishte plot me të gjitha llojet e frutave.¹* Sevastia jo rastësisht në këtë kuadër na i pasqyron dhe disa nga elementet arkitekturore të ngrehinës së banimit të tyre në këtë kompleks informacioni përshkruar. Kulturën e ndërtimit, përbërjen e materialit ndërtimor të ngrehinës, tipologjinë e dukjes nga brenda dhe jashtë saj, etj. Në të njëjtën kohë bën fjalë edhe enterierin e brendshëm të shtëpisë së banimit të asaj familjes, gjë e cila detyrimisht na bënë përshypje të veçantë, ngase pasqyron kushtet e rrethanat në të cilat zhvillohej njeriu ynë, nivelin e standardit jetësor, nivelin e kulturës dhe emancipimit,

¹Sevastia Q. Po aty.fq. 67.

shkollimit e zhvillimit të shkencës mbi një shekull përpara nesh. Ajo veproi ende përpara se ne të kishim një alfabet tonin në shkallë kombëtare e që kjo dha kontribut të madh lidhje me realizimin e kësaj vepre madhore për kombin. Përmes këtyre të dhënave të shkruara nga ky personalitet i shquar i veprimtarisë patriotike, intelektuale dhe letrave i cili veproi me përkushtim në ato kohë të errëta për kombin tonë duke nxjerrë në pah në mënyrë autentike një sërë elementesh nga jeta dhe veprimtaria e paraardhësve tanë në kushte të një robërie të rëndë nga të huajt. Ajo, me theks të veçantë e drejton gishtin te pushtuesit turq, dhe mbijetesën e shqiptarëve duke qëndruar stoikisht përballë kësaj së keqe e cila na ka përcjellë ndër shekuj. Në të njëjtën kohë edhe duke ruajtur elementet e traditës së vjetër ndër shekuj në fundamentin e tyre pandryshuar; të pakërrusur e nën vështirësi të mëdha edhe në këtë segment jete të cilat i përmendëm më lartë. Zonja Qiriazhi në vazhdim përvijon edhe një element nga trashëgimia jonë tejet të rëndësishëm. Organizim-festimin tradicional rreth lindjes së foshnjave dhe përgëzimet e që vinin të i bënin familjes së foshnjës, familjarët nga lidhja e gjakut dhe, në të njëjtën kohë, pagëzimin e tyre. Ca karakteristika rituale lidhje me fatimin e lindjes së foshnjave në ato kohë ku si më poshtë ajo shprehet: *Para mesnatës të gjithë mysafirët kishin ikur, sepse atëherë pritej të vinin Fatat, të cilat do ta vendosnin fatin e foshnjës. U la një llambë e ndezur për gjithë natën, që Fatat ta kishin të lehtë të gjenin rrugën për te djepi. Kur dy prej motrave tëçuditshme kanë thënë fjalën e tyre, fletë dhe e treta, dhe vendimi i saj është i formës së prerë.* Besimin popullor në Fatat të cilat i jepnin emrin foshnjës së porsalindur në krye të tre ditëve pas lindjes, apo në të tretën e natës, sipas traditës së vjetër e hasim si njoftim në mënyrë të shkruar nga autorë shqiptarë të asaj periudhe ndoshta për herë të parë në mënyrë origjinale edhe të përjetuar, por edhe si dokument i shkruar i cili vjen sot përmes veprës së z. Sevastia. Këto të dhëna shikuar nga këndi etnokulturor në këtë mënyrë nga fusha e studimeve etnologjike shqiptare ka një peshë të veçantë, ngase e ka burimin nga përjetimi i drejtpërdrejtë i zonjës në fjalë, por dhe që në mënyrë të shkruar na i ka lënë si dokument nga një personalitet shqiptar që përpara mbi njëqind vjetëve, andaj edhe është tejet i qëndrueshëm por dhe autentik.

Një e dhënë e rëndësishme lidhje me edukimin dhe përgatitjen për punë e detyra në të ardhmen që iu bëhej vajzave në kohët kur jetoi z. Sevastia që vazhdon si më poshtë: *Vetëm të dielën luanim, veçanërisht vajzat, sepse ato mësoheshin qysh në moshë të re të ndihmonin në të gjitha llojet e punëve të shtëpisë. Atyre u mësohej të bënin thurje, tjerrje, qepje, endje dhe gjithashtu si të prodhonin gjëra prej leshi; çorape, qilima, rrugica, batanije dhe pëlhurë.*¹Me këtë rast zonja Sevastia në të njëjtën kohë e portretizon përmes kujtimeve të saj ambientin fizik jetësor të familjes së saj, dhe atë mbarëshoqëror e kulturor jetese, dhe kushteve të kohës. Por njëkohësisht na len si informacion tejet sublim trashëgimie ndërtimin kultit(adhurimit) të punës të cilin në ato ambiente dhe hapsirë kohore e ndërtonte njeriu ynë, e që më në fund punën e konsiderojnë edhe si adhurim edhe si obligim të patjetërsueshëm për ndërtimin e ardhmërisë së njeriut, apo thjeshtë për mbijetesë. Ndaj detyrohemi të theksojmë, se vizioni intuitiv vlerash të larta të saj në vetë këto të dhëna shkrimore na paraqitet me pikësynim të largët në perspektivë ndërtimi të njeriut tonë sipas saj në kohë dhe hapësirë. Prandaj duhet theksuar se, aty ku s'ka punë s' ka prodhim, s' ka mirësi, aty ku s'ka prodhim s'ka jetë, s'ka lumturi e as ardhmëri, andaj natyrisht puna mbetet obligim i patjetërsueshëm e jo vullnet e dëshirë nëse do qoftë personi apo rrethi i gjerë shoqëror ta ndërtoj ardhmërinë. E lidhje me këto z. Sevastia, na e sheshon përmes përshkrimit të saj përveç tjerash anën edukative të cilën familja e rrethi ia ofron në forma të ndryshme pasardhësve, gjeneratave të reja, në ato kohë, se puna e ngritë njeriun, e që përmes saj ata mund në të ardhmen ta ndërtojnë jetën më mirë dhe përmes saj ta gjejnë lumturinë.

¹S. Qiriazhi po aty fq. 68.

Gjithashtu në faqet e kësaj vepre hasim të dhëna edhe mbi mjekësinë popullore lidhje me trajtimin dhe mbrojtjen e lehonave. Mënyra praktike e ruajtjes nga demonët dhe syri i keq, më pastaj nga dobësimi i shëndetit dhe viruset bartëse të cilët mund t'i shkaktonin lehonës probleme të ndjeshme, e ndonjëherë edhe ato të rënda nga të cilët mund të i rrezikohesh edhe jeta. Andaj familjarët që e rrethonin lehonën bënin kujdes të veçantë për ta mbrojtur atë, duke u bazuar në të dhëna nga paraardhësit, nga tradita e vjetër, pra mjekësia popullore e kohës. Në vazhdim disa të dhëna nga metodologjia praktike e shprehur si në vazhdim nga z. Qiriazzi: Për dyzetë ditë as nëna dhe as foshnja nuk dolën nga shtëpia, as nga dhoma, pas perëndimit të diellit. Nëna dhe foshnja asnjëherë nuk u lanë vetëm në dhomë gjatë kësaj periudhe. Nëse rastësisht personin e thërrisnin të dilte, pranë djepit lihej një fshesë për të mbajtur larg syrin e keq.¹ Kjo rregull praktike e zbatuar nga njeriu ynë në atë periudhë e ka burimin thellë nga besimet popullore të traditës së lashtë ndër popullin tonë, dhe ajo haset edhe sot në shumë krahina shqiptare vetëm që mund të ketë dallime fragmentare për ndonjë nuancë por në tabanin e saj fundamental mbetet e njëjta. Ta zëmë në Kumanovë – Preshevë në vend të fshesës foshnjës në këso rastesh ia linin e ia lënë edhe sot pjesërisht nënat e gratë tona një enë me ujë aty pranë, e pa të nuk bënte të lihej vetë foshnja e cila nuk i ka mbushur ditët, pra nuk i ka kaluar 40,të ditë jetë nga lindja e tij-saj. Andaj të gjitha këto që i cekëm më lartë praktikoheshin tejet me korrektësi. Por ky besim – bindje ishte i mbjellë se fshisa apo uji pranë foshnjës e ka fuqinë mbrojtëse deri magjike, andaj njëri element mbrojtës apo tjetri besohet se i largon demonët e syrin e keq, por edhe nga më shumë element të cilët mund të i sjellin të padëshirueshmet të porsalindurit po dhe lehonës. Njëkohësisht ajo potencon se lehona për dyzetë ditë gjatë natës mbante ndezur dritën e llambës që kur binte muzgu dhe derisa zbardhte agimi. Elementi i parë i lartë theksuar dhe ky, përhershëm pleksen në një në kësi rastesh. Që të dy këto besime me rrjedhë nga tradita popullore e shekujve i shërbenin për të njëjtin qëllim lehonës dhe foshnjës. Drita e ndezuar gjatë natës konsiderohej se do ta mbronte edhe foshnjën edhe lehonën nga ndonjë e goditur që mund t'iu shkaktonte probleme shëndetësore nga syri i keq, dhe keqbërësit e padukshëm, demonët, magjistaret, etj, siç shpreheshin në leksikun popullor, njëres dhe palës tjetër. Sipas besimeve popullore figurat keqbërëse mitike dhe mistike përpara zjarrit e humbin fuqinë vepruese të tyre, andaj ata besonin se kjo metodë mbrojtëse ka pasur sukses lidhje me këto çështje.

- Një segment tjetër nga kultura popullore e asaj pjese shqiptare të cilin na i ofron për kohën. Qiriazzi flet për fenomenin e martesave të popullsisë sonë në atë periudhë. Ta zëmë vajzat dhe djemtë atëherë hynin në bashkëshortësi më të rinj se sa sot, e ndër të tjera ajo lidhje me këtë thekson: *Në këtë kohë motra ime e madhe mbahej e mbyllur brenda, sepse ajo ishte 12, vjeç dhe gati për martesë. Ajo e shfrytëzonte çdo minutë. Përveç të qenët shumë aktive në të gjitha punët e shtëpisë, kishte edhe detyrën e rëndësishme për të bërë gati pajën e vetë.*² Lidhje me martesat dhe moshën e hyrjes në bashkëshortësi e të rinjve në ato kohëra përsëri jemi të detyruar të theksojmë, se edhe ky segment për të cilin bën fjalë zonja bartë peshë të rëndësishme ngaqë kemi një burim të shkruar me relevantë për të cilin fletë ajo. Shqiptarët në ato kohë edhe pse vuanin nën pushtim të osmanlinjve me fanatizëm ruanin dhe i kultivonin rregullat e tyre nga e kaluara e thellë e traditës sonë ndër shekuj. Ndaj edhe moshën e hyrjes në bashkëshortësi e kishin të rregulluar sipas kodikut të tyre të veçantë, Kanuni shqiptar; përmes së cilit ishin të përcaktuara normat, por dhe të zbatueshme në praktikë tejet me korrektësi. Ne do të shprehim mendimin e mospajtimin me normën e cila përcakton atë moshë të re që rinia e asaj kohe të hynin e lidhnin martesat, e që priremi të

¹S. Qiriazzi; po aty fq. 73.

²Sevastia Qiriazzi, Po aty fq. 78.

jemi të bindur se kjo mund të ketë qenë ndoshta jo e përpunuar mirë si logjikë e këtij segmenti por realiteti ynë i kohës ka qenë ky, i dukshëm dhe i prekshëm. Brenda këtyre rreshtave hasim të ketë të dhëna të një rëndësie specifike siç e përshkruan z. Sevastia kur thekson se motra e saj kishte dymbëdhjetë vjet dhe ishte e mbyllur në shtëpi, por që ajo shfrytëzonte çdo minutë përveç detyrave të tjera në punët e shtëpisë për të përgatitur pajën e nusërisë së saj në këtë kuadër. Një popullsi të cilës i mungonte shkollimi dhe zhvillimi i kulturës institucionale, dhe institucionet përkatëse të ngritjes ekonomike të pavarura ndër ata njerëz funksionin disa rregulla të pashkruara edukative tejet mirë, në kushtet në të cilat bënë jetë. Lidhje me sjelljen e tyre në raport me atë, kudo që ndodheshin, dhe mbi të gjitha me edukimin në punë e detyra të moshave të reja gjë e cila na jep shembull tejet pozitiv me praktikën e këtij segmenti, pra punën e cila ishte shndërruar si koncept; detyrim, deri në adhurim për mirëqenie dhe ndërtimin e perspektivës në të ardhmen për moshat e reja të popullsisë ishte gjë tejet pozitive.

Ajo në vazhdim përmes rrëfimit gjithashtu në formë të shkruar na jep të kuptojmë se dasma shqiptare në ato kohë, dhe që vazhdon sipas nesh deri në vitet 1970-të, në shumicën e popullsisë shqiptare ka zgjatur për disa ditë, pra thuaja diku pesë ditë e pjesë tjera një javë të tërë, dhe thekson: Festivali martesor zgjati një javë të tërë.¹ Rreth ceremonialit të dasmës ndër shqiptarë, në të kaluarën bëjnë fjalë më shumë personalitete shkencore të fushës së etnologjisë, e që edhe autori i kësaj trajtëse ka publikuar dy punime me këtë tematikë në të cilat bëhet fjalë për ceremonialin e dasmës ndër shqiptarë. Organizimi i dasmës ndër popullin tonë në të kaluarën vërtetë bëhej i kushtueshëm për kushtet e rrethanat në të cilat bënte jetë populli ynë, ngase në manifestime të tilla shpenzohej aq shumë sa etnologia e njohur shqiptare Andromaqi Gjergji, në një vend të studimeve të saj thekson se, në dasmat shqiptare në të kaluarën bëheshin aq shumë shpenzime rreth hajeve dhe pijeve që kalonin deri në keqpërdorim. Andaj në të dhënat të cilat na i përshkruan z. Sevastia lidhje me dasmën shqiptare të Manastirit e më gjerë në kohën kur jetoi dhe veçoi ajo na i ofron pasqyrën reale të traditës sonë të para një shekulli që ka të bëjë ne organizimin e dasmës shqiptare konkretisht nga këndvështrimi i saj real. E kjo e dhënë ka rëndësi të veçantë meqë fletë me gjuhën e realitetit objektiv të prekshëm të asaj periudhe, por që edhe kjo praktikë jona e traditës ka rrjedhë shumë të vjetër ndër popullin tonë, megjithëse nëpër kohë duhet të ketë përjetuar transformime siç ka ndodhur në kohën tonë duke u bazuar në kushte e rrethana të aktualitetit kur edhe ka ndodhur.

Mëtej z. Sevastia na ofron edhe një informacion tejet të rëndësishëm të kohës përmes jetëshkrimit të saj mbi veshjen e dhëndrit të atij nënqielli shqiptar, siç ishte Manastiri dhe e tërë Shqipëria. *Veshja shqiptare është jashtëzakonisht elegante, por shumë e kushtueshme. Shqiptarët e Jugut veshin fustanellën e zakonshme të bardhë me gjunjakët e qëndisur dhe me opingat, që grekët i kanë marrë për uniformën e truprojave të mbretit.*² Dy fjali por me përmbajtje sublime me të cilat ajo na ofron thesare njohurish mbi koloritin e ndërtimit dhe bukuritë e rralla të veshjes shqiptare të kohës të cilat i bartte dhëndri në ditën që hynte në bashkëshortësi. Në këtë kuadër e hasim të na ofroj dëshmi se në atë periudhë, fustanellën, veshjen e burrave si kostum karakteristik dhe me bukuri të rralla si dizajni i papërsëritshëm populli ynë ta ketë përdorur deri vonë, edhe si përmbajtje stili dhe komponentë tjerë bashkëdyzues. Dhe, ajo bën fjalë tejet shkurtë por cilësisht kur thekson se rojet e mbretit të Greqisë si veshje të tyre morën nga kultura e veshjes shqiptare dhe të njëjtat i improvizuan e i bartin atëherë edhe sot. Lidhje me fustanellën si një veshje karakteristike shqiptare nga tradita jonë si kulturë dhe dizajni e prodhimi të veçantë bënë fjalë në studimet e saj A. Gjergji, e cila dëshmon se kjo tipologji veshjeje burrash u krijua nga kreatorët tanë të

¹ S. Qiriazi, Po aty, fq. 77.

²Po aty, fq. 80.

veshjeve në kohë dhe hapësirë e që është me prejardhje autentike autoktone, me rrjedhë nga dorë mjeshtërisht tanë të kohës. Ajo shikuar nga këndi i saj i vështrimit ndër të tjera thekson se populli ynë ka shije të hollë mbi artin dhe bukurinë e veshjeve. Por që ato kushtonin shtrenjtë për t'i blerë në kohën për të cilën flet ajo. Lidhje me fustanellën si veshje shqiptare burrash sipas studimeve të A. Gergjit, e hasim të jetë bartur deri vonë në fillimet e shek. XX-të, në gjithë arealin shqiptar, dhe ne do të theksonim se gjurmë të kësaj veshje ka pasur edhe në Kumanovë deri rreth viteve tridhjetë por të rralla të shekullit XX sipas rrëfimit të disa personave të cilët edhe personalisht i kanë përjetuar e të cilët i kemi konsultuar drejtpërdrejtë. Zonja Andromaqi lidhje me këtë në studimet e saj thekson: Spenseri një udhëtar anglez në veprën e tij shkruan: Se me 1847, ka takuar shqiptarë të veshur me fustanellë edhe në luginën pjellore të Toplicës në Mezinë e Epërme, pra në perëndim të Nishit.¹Ndaj prapë do të theksonim se të dhënat e saj lidhje me këto kanë peshën e vetë rëndësie të veçantë si e dhënë burimore që një veshje e tillë ka pasur shtrirje edhe në hapësirat e Manastirit kur edhe jetoi e veproi ajo. Sevastia më tej përshkruan edhe veshjen e grave shqiptare të kohës të cilat i ka prekur dhe shijuar vetë. Ajo me subtilitet të fortë syri i vështron ato dhe i portretizon përmes kujtimeve të saj dhe na i len trashëgimi njohurish me vlera. Lidhje me këto ajo si më poshtë thekson: *Veshjet e grave janë fantastike dhe ndryshojnë sipas zonës. Disa veshin një lloj kapuçi të bardhë leshi dhe gratë e reja veshin një kësulë të bërë nga monedha prej ari dhe argjendi. Flokët e tyre i thurin në gërsheta të gjatë të cilët i lidhin me monedha.* Brenda këtyre tri fjalive kjo itnelektuale e shquar pleksë një mori karakteristikash të veshjes së grave të asaj kohe dhe ambienti ku kjo jetoi dhe më gjerë. Në radhë të parë është tejet me interes të theksohet se zonja Sevastia veshjet e grave tona i sheh me sy admirues deri të mrekullueshme, pra shumë të bukura dhe me vlera. Dhe më pastaj ajo na ofron një detaj tejet të rëndësishëm kur thekson lidhje me veshjet e grave se paraqiteshin shumë më të koloritshme se ato të burrave meqë ndryshonin sipas zonës. Nga kjo që thekson zonja në fjalë lidhje me koloritin e veshjeve na i përforcon edhe më shumë njohuritë mbi kulturën dhe koloritin e veshjes së shumënduarshme të grave në atë kohë. Me theks të veçantë na zgjon interes e dhëna kur ajo përshkruan në kuadër të veshjes së grave një lloj kapuçi të bardhë leshi, gjë që na jep ta kuptojmë se niveli i zhvillimit të mirëqenies ishte i ulët, por dhe njëkohësisht gruaja shqiptare kishte prirje të mëdha në kreativitetin e të bukurës, të cilën ajo e krijonte vetë me duart e saja në kushtet dhe ambientin në të cilin ishte e detyruar të bënte jetë aktive. Dhe në të njëjtën kohë ajo me përkushtim krijonte vlera substanciale me rrjedhë nga subtiliteti logjik, duke ndërtuar ngrehinën e ekonomisë familjare në kushte të një mbylljeje të saj brenda mureve të shtëpisë por pa iu larguar pretendimit për të krijuar edhe artin e veshjes e të bukurës për vete dhe familjen e saj në të ardhmen. Kësulat e tilla prej leshi të deleve të cilat i përdornin gratë i hasim në atë periudhë kur jetoi zonja të kenë qenë në përdorim e të njëjtat janë prodhuar në më shumë krahina shqiptare e të cilat i kanë përdoruar femrat në ditën e nusërimit. Këto lloj kësula dalloheshin vetëm sa i përket ngjyrës së tyre. Sipas disa të dhënave për nusen ka qenë kësula me ngjyrë të kuqe siç i hasim të jenë përdoruar në arealin e Malit të Zi të Shkupit, Kumanovë – Preshevë, dhe Anamoravë e Kaçanik, deri në çerekun e parë të shk- XX-të. Të njëjtat i quanin ciculka e nuses, meqë vërtetë forma e saj fizike i përngjet gjirit të femrës, e që ndër këto anë gjirin e thërrasin pjesërisht nga koha, cicë, cica, apo në një pjesë të këtyre anëve dhe kapuçi i nuses. Vështruar nga këndi ynë, kjo e dhënë e zonjës na ofron dëshmi relevante për përdorimin e kësaj pjesë veshje të grave në atë kohë e që përmes kësaj na e përforcon njohuritë lidhje me këtë jo vetëm në pjesën e trullit shqiptar ku jetoi dhe veproi zonja, por edhe në krahina tjera të popullsisë sonë. Detyrimisht do të theksonim se lloji i kësulave të bardha prodhuar prej leshi të deles i cili punohej në dorë, me anë të shtizave nga gratë tona më shumë ka gjetur përdorim në popullsinë e fshatit. Kurse kemi dhe ato të nuseve të stolisura me monedha ari e argjendi me përmasa më

¹Gjergji Andromaqi – Veshjet shqiptare në shekuj. A. Sh. Sh. Tiranë 2005. Fq. 54.

të mëdha që gjenin përdorim në qytet nga nuset e reja, por që edhe njëhënë edhe tjetrën e hasim të jenë përdoruar duke u bazuar në kushtet ekonomike të familjes dhe disa faktor të tjerë dyanshëm.

Një detaj tjetër tejet me interes, i cili e ka rrjedhën nga kohëra tejet të hershme nga shikuar nga këndi i etnokulturës shqiptare është edhe e dhëna si më poshtë: Gjatë festimeve martesore në shqiptarët kërcejmë shumë valle, por më të rëndësishmet janë ato me shami, Vallja e Pirros. Pirroja ka qenë një personalitet udhëheqës të cilin e njih historia jonë edhe si luftëtar i denjë i kohës meqë kishte bërë luftëra të mëdha dhe ai arrin të bashkojë në vitin 280, p.e.s. fiset epirote. E populli këtë emër të shquar në shenjë respekti për të e përkujton edhe përmes valles të cilën e shfaqin, përmes valëzimit, dhe ia kanë adoptuar tipologjikisht karakterit dhe rëndësisë së këtij personaliteti të rëndësishëm të periudhës kur jetoi ai.

Në vazhdim zonja Qiriazi e portretizon përmes shkrimeve të saj, organizimin e festave fetare, siç janë Krishtlindja dhe Pashka, por në këtë kuadër mbi të gjitha i jep rëndësi kremtes pagane; *Shën Gjergjit; rreth së cilave ajo thekson: Festimet e Krishtlindjes dhe të Pashkës ishin ndodhi të mëdha për ne në fëmijërinë tonë, por asgjë nuk ia kalonte dot ceremonisë festive për ditën e shenjtit tonë të mbrojtjes, Shën Gjergjit me 23. prill. Ky zakon na ishte transmetuar brez pas brezi qysh në lashtësi.* Shqiptarët si një etni ndër më të vjetrat e Ballkanit dhe Evropës e mund të futet edhe më thellë në histori dhe të ketë shënuar gjurmë edhe më gjerë nëpër periudha i kanë ndërtuar edhe besimet e tyre popullore nga kohëra të hershme, që në antikitet paraardhësit tanë Ilirët. E këto sipas disa pak të dhënave në të kaluarën dhe atyre aktuale të studiuesve shqiptarë e të huaj kremtet e besimeve popullore të paganizmit ndër ta hasen të kenë pasur shkallë të lartë zhvillimi për kohën, që para epokës sonë, para Krishtit. Por që ato si mbijetoja të traditës kanë arritur deri në ditët tona pjesërisht si dëshmi të ngritjes kulturore përhershëm të njeriut tonë. Sevastia spikat në kujtimet e saja tejet shkurt disa të dhëna nga kënde të ndryshme të traditës, e të cilat na e bëjnë të mundur të shenjëzohen disa segmente ngjarjesh rituale e kremtesh, por edhe ndodhish tejet të rëndësishme nga tradita e vjetër e shqiptarëve ndër periudha. Dhe si dëshmi që përpara një shekulli z. Sevastia e pasqyron shkurtazi por me subtilitet i përshkruan një sërë detajesh. Edhe pse zonja Qiriazi me familjen e saj kishin bërë jetë në qytet dhe nuk ishin marrë me punë bujqësie, ata dhe mbarë popullsia shqiptare kudo që jetonte këtë kremte të vjetër me historik që parailir, pra të themi përpara ilir, e ruajti dhe e kultivoi për shekuj me radhë në mënyrë të veçantë dhe dinjitoze. Mandej, nuk e ndërliði as me religionin e krishterë siç e pretendonin ana e religjionit monoteist krishterë dhe më pastaj ata islam të cilët e mohonin një gjë të tillë, por e mbrojti frymën e mëvetësisë së saj nga rrjedha e trashëgimisë së saj të hershme në formë dhe përmbajtje.

Një tjetër të dhënë ilustrative lidhje me traditën shqiptare që daton shumë herët në këtë kuadër, pra që e lidh me kremten e Shën Gjergjit por që ka të bëjë me një karakteristikë sjelljeje e raporti me mikpritjen shqiptare që tejkalonte paksa disa caqe normalitetin e respektit për mikun ku ndër të tjera ajo e sheh me këtë sy dhe e pasqyron në kujtimet e saj: *Ushqimi që u nxirrej mysafirëve (për këtë kremte) ishte i mjaftueshëm që të na mbante si familje për një muaj të tërë.* Një veprim, dhe sjellje e tillë e shqiptarëve me mikun apo miqtë ka qenë realitet i dukshëm dhe i prekshëm nga hera dhe, edhe kjo rregull bartet nëpër periudha e gjallon pjesërisht deri në vitet 80-të e më pas të shek-XX-të si e tillë. Por kuptohet tejet mëme racionalitet në kuptimin e shpenzimeve në krahasim me metodën e vjetër. Pra në traditën shqiptare si për dasma e ahengje, për festa të ndryshme qoftë të paganizmit ato religjioze të monoteizmit etj, në të cilat ftoheshin miq e të ftuar tjerë bëheshin shpenzime të mëdha deri në shpërdorim siç theksojnë edhe disa autorë, studiues të etnokulturës shqiptare. E Sevastia nga këndi i saj na e përforcon këtë dëshmi se edhe

në atë hapësirë shqiptare një element i tillë i mikpritjes ishte identik si kudo ndër shqiptarë. Ajo në vazhdim e pasqyron gjendjen emocionale të momentit në ditën e caktuar dhe atë të mëngjesit se ç'ngjyrim të veçantë merrte kur thekson: *Kur agonte dita e Shën Gjergjit, gëzimi ynë arrinte kulmin e lumturia jonë nuk kishte kufi.*¹ Kjo na përkujton thuajse një shekull më pas se edhe ne në fëmijërinë tonë kishim përjetuar gjendje të tillë emotive lidhje me këtë kremte të paganizmit që lidhej me besimin popullor me shenjtin Shën Gjergj; me rastin e ditës së caktuar kur konsiderohej se dualëm në verë. Ndaj e dhëna e saj për kohën dhe atë ambient përmban relevancë dhe peshë për historikun e zhvillimeve të traditës sonë popullore në kohë.

Kjo intelektuale shqiptare e asaj kohe, pra e një shekulli e më shumë nga këndi i etnokulturës sonë popullore me gjeturinë e mendjes së saj të ndritur të kap gjëra tejet me interes si dëshmi e një realiteti dhe na ofron disa të dhëna duke piketuar një sërë temash. E në kohën tonë këto na vinë si informacion autentik që na i sjell përmes kujtimeve të saj lidhje me trashëgiminë e besimeve popullore të paganizmit. Ajo me theks të veçantë na vë në kujtesë kur bënë fjalë për lutjen e rënies së shiut në kohëra thatësire nga organizimi që bëhej me atë rast, për lutje të reshurash shiu, e që quhej Dodola. Këtë emërtim kremteje të vjetër pagane të njohur si Dodola, dudola, e hasim ndër popullin tonë gjithandej në të kaluarën e afërt deri rreth viteve 1960-70, edhe në rrethinat e Kumanovës. Këtë kremte të vjetër e gjejmë të ketë gjalluar në praktikën jetësore të popullsisë sonë por dhe te disa më të rinjë në mbamendjen e qytetarëve të rajonit të Kumanovës dhe Preshevës me të njëjtin ndërtim leksikor dhe formë organizimi nga e kaluara deri pas viteve 1990-të. Do të theksonim se me një emërtim të tillë, “Dodola” nga studimet e deritashme mbi besimet popullore shqiptare të cilat i kemi pasur në duart tona, nuk e kemi hasur të njihet në asnjë krahinë tjetër shqiptare përveç në Kumanovë – Preshevë dhe sipas Sevastisë kuptuam se edhe në Manastir ka pasur të njëjtin emërtim. Këtë besim ritualistik të dikurshëm, i cili ishte organizuar ndër popullsinë tonë si dëshmi rrëfimtare edhe në personalisht gjatë ekspeditave shkencore e kam hasur dhe kam vjellë të dhëna lidhje me këtë festë të vjetër të paganizmit në këtë rajon dhe që gjendet në një botim timin shkencor që ka të bëjë me besimet popullore shqiptare të Kumanovës. Sevastia në kujtimet e saja flet shkurtazi edhe për këtë organizim-kremte të besimeve popullore si në vazhdim: *Kur vjen moti i nxehtë dhe ka nevojë për shi, janë “dodolatë” që luten për popullin. Unë kisha dëgjuar për këtë zakon të veçantë, por nuk kisha parë asgjë në lidhje me të. E kemi theksuar edhe më lartë se zonja e nderuar. Sevastia pjesë nga fëmijëria dhe rinia e saj sipas të dhënave e ka kaluar në qytetin e Manastirit dhe që nuk ka pasur qasje të rregullta ta shijoj jetën e fshatit gjithaq. Megjithatë ajo i ka zënë disa detaje me rrjedhë nga besimet popullore të zbatueshme në atë periudhë përreth tyre ndër popullsinë e fshatit, e cila i praktikonte ritualet e besimeve popullore siç ka qenë edhe riti i doivolës, lutjes për të rënë shi në periudha thatësirash gjatë muajve të verës në mënyrë që të kishin prodhime të të lashtave bujqësore. Andaj, ajo këtë manifestim të lutjes për të rënë shi e sheh me kureshtje dhe interesim dhe, edhe për këtë na ka lënë disa detaje në të cilat rrëfen lidhje me dodolat si veprimi e organizimi i tyre me interes për trashëgiminë e besimeve popullore të një periudhe. Ajo lidhje me ritualin, dodolat; vazhdon përshkrimin e saj edhe më të detajuar: *Kur thatësira kërcënon të shkatërrojë të mbjellat, sipas zakonit tonë, një vajzë e vogël apo një djalë i vogël vishet me gjethe dhe lule. Kjo vajzë e luleve është personifikim i natyrës që këlthet për shi. Turma i brohoriste një lutje Elias, shenjtorit të reve, që të dërgonte shi për misrin.*² Në fund të kësaj trajtесе do të theksonim se personaliteti i kësaj intelektuale shqiptare të kohës na detyron ta vlerësojmë nga shumë kënde veprimtarinë e saj. Ajo ishte mësuese, veprimtare politike, luftëtare që prinë në*

¹S. Qiriazhi, po aty fq. 81.

²S. Qiriazhi, po aty, fq. 134.

organizimin dhe themelimin e shkollës së parë shqipe në Korçë, si një personalitet i çmuar i brumosur me ndjenjë të lartë patriotike, dhe që me intuitën e hollë largpamëse në fund na sjell dhe na len veprën e saj të shkruar kujtimesh e cila për të kaluarën tonë të asaj periudhe veçanërisht në Manastir, na është burim tejet i çmuar. Ajo përmes librit të kujtimeve “Jeta ime” na ofron një sërë të dhënash autentike lidhje me shumë segmente të zhvillimit edhe të ngjarjeve të kohës, por edhe nga trashëgimia shqiptare e arealit shqiptar ku edhe kryesisht jetoi dhe veproi z. Qiriazi.